

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses N.P ''K.P.'', me seli në ..., të cilën me autorizim e përfaqëson Gj. D., avokat në ... kundër të paditurave Komuna e Mitrovicës, me seli në Mitrovicë, Republika e Kosovës Ministria e Infrastrukturës dhe Republika e Kosovës Ministria për Kthim dhe Komunitete, të cilët me autorizim i përfaqëson Naime Abazi, nga Prishtina, për shkak të borxhit, vlera e kontestit në shumë prej 38.800,00 €, përkitazi me revizionin e të paditurave Republika e Kosovës Ministria e Infrastrukturës dhe Republika e Kosovës Ministria për Kthim dhe Komunitete, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.217/2016 datë 12.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 2.7.2019, merr këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurave Republika e Kosovës Ministria e Infrastrukturës dhe Republika e Kosovës Ministria për Kthim dhe Komunitete, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.217/2016 datë 12.12.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.217/2016 datë 12.12.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses N.P ''K. P.'', me seli në ..., dhe ankesat e të paditurave Komuna e Mitrovicës, me seli në Mitrovicë, Republika e Kosovës Ministria e Infrastrukturës dhe Republika e Kosovës Ministria për Kthim dhe Komunitete, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomik, III. C.nr. 1/2015 datë 17.3.2016, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe janë detyruar të paditurat që në mënyrë solidare të paguajnë për periudhën kohore prej 1.6.2011 deri më 31.12.2011 shumën prej 15.600 € dhe shumën prej

10.688 € për periudhën prej 13.1.2012 deri më 31.12.2012, e që gjithsejtë është shuma prej 26.288 €, me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë më 11.1.2012 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm. Me pjesën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses në shumën prej 7.512 €. Me pjesën III të dispozitivit janë detyruar të paditurat që paditëses t'ia kompensojnë shpenzimet e procedurës civile në shumën e përgjithshme prej 2.228 €, në afat prej 7 ditësh, nga data e pranimit të aktgjykimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë të paditurit Republika e Kosovës Ministria e Infrastrukturës dhe Republika e Kosovës Ministria për Kthim dhe Komunitete, të cilët i përfaqëson Ministria e Drejtësisë – Avokatura Shtetërore, me kohë kanë paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar dhe ai i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohen ashtu që kërkesëpadija e paditëses të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas dispozitës së nenit 215 të LPK-ës, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja nga nëntori i vitit 2003 ka kryer transportin humanitar për banorët e Kodrës së Minatorëve në Mitrovicë, në relacionin Kodra e Minatorëve - qytet dhe anasjelltas. Kontrata nr. ..., datë 16.6.2008 e lidhur në mes paditëses dhe të paditurës Ministrisë për Kthim dhe Komunitete është përmbush në tërësi sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës të datës 17.8.2011 në shumën prej 89.700 €, për periudhën kohore prej 1.2.2007 deri më 30.6.2011. Paditësja ka kryer shërbimet edhe për periudhën kohore prej 30.6.2011 deri më 13.1.2012, ndërsa me kontratën nr. ..., datë 13.1.2012, Ministria e Infrastrukturës ka kërkuar shërbime për transportin e udhëtarëve nga paditësja, për periudhën kohore prej 13.1.2012 e deri më 31.12.2012 me çmimin fiks në shumën prej 10.688 €.

Paditësja me padi ka kërkuar ti bëhet pagesa për periudhën kohore nga data 30.6.2011 deri më 13.1.2012, mbasi që i ka kryer shërbimet e transportit dhe për periudhën kohore prej 13.1.2012 e deri më 31.12.2012, në bazë të kontratës nr. ..., datë 13.1.2012, të Ministrisë së Infrastrukturës për shërbimet e kryera.

Me aktvendimin Ae.nr. 445/2012, Gjykata e Apelit e Kosovës, ka aprovuar ankesën e paditëses dhe ankesën e të paditurës, ndërsa ka prishë aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë C.nr. 38/2012 datë 27.3.2014 dhe çështjen ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar, ashtu që baza juridike e kërkesëpadiës qëndron në kontratën nr. ..., e cila konsiderohet si kontratë në heshtje për periudhën kohore 30.6.2011 deri më 13.1.2012, konform nenit 42 par.3 të LMD –ës dhe në bazë të kontratës nr. ..., datë 13.1.2011 sa i për ketë shumës prej 10.688 €, pastaj ka obliguar të paditurat që paditëses në mënyrë solidare t'i paguajnë shumën e përgjithshme prej 26.288 €, më afër përshkruar si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar, pastaj ka refuzuar si të pabazuara ankesat e paditëses dhe të paditurave dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike në bazë të së cilës në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar. Aktgjykimet e goditura të gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për vendosjen e drejtë të kësaj çështje juridike, të cilat arsye i pranon edhe kjo Gjykatë e

revizionit, ndërsa aktgjykimet e goditura nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, të pabazuara i vlerësoi theksimet nga revizioni se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse në revizion nuk është cekur asnjë pretendim se ku qëndrojnë shkeljet thelbësore, në cilën pjesë të aktgjykimit, apo në çka manifestohen ato, ndërsa kjo gjykatë shqyrtojë aktgjykimin e kundërshtuar konform nenit 215 të LPK –ës, vetëm në pjesën e goditur me revizion dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejt të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimin e revizionit se aktgjykimi i kundërshtuar dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë me zbatim të gabuar të drejtës materiale, por një pretendim të tillë e vlerësoi si të pabazuar, ngase me të drejt gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se paditësja dhe të paditurat kanë qenë në marrëdhënie të vazhdueshme sipas kontratës nr. 1247 datë 16.6.2008 dhe kontratës nr. ..., datë 13.1.2012, andaj në kuptim të nenit 42 par.3 të LMD –ës mes palëve është krijuar raporti detyrimor, ndërsa të paditurat edhe përkundër faktit të pranimit të shërbimeve dhe mos kontestimitin e tyre kanë refuzuar pagesat. Është i pabazuar pretendimi i revizionit se në rastin konkret nuk mund të konstatohet vazhdimi i kontratës në heshtje, sepse sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, paragrafi 5 i nenit të cekur parasheh se nëse oferta, përkatësisht urdhri nuk është refuzuar, konsiderohet se kontrata është e lidhur në çastin kur oferta, përkatësisht urdhri i ka arritur të ofertuarit. Në rastin konkret paditësja ka ofruar shërbimet e saj për transportimin e udhëtarëve nga Kodra e Minatorëve për në pjesën jugore të Mitrovicës dhe anasjelltas, për periudhën kohore nga data 1.6.2011 deri më 31.12.2011, ndërsa të paditurat nuk kanë refuzuar shërbimet e ofruara dhe pagesën nuk e kanë bërë.

Sipas kontratës nr. ..., datë 13.1.2012, Ministria e Infrastrukturës ka kërkuar shërbime për transportin e udhëtarëve nga paditësja për periudhën kohore prej 13.1.2012 deri më 31.12.2012 me çmim fiks në shumën prej 10.688 €, e cila shumë nuk i është paguar paditësës edhe që e njëjta ka kryer shërbimet sipas kontratës, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së dytë

ka vlerësuar se në kuptim të nenit 26 dhe 67 të LMD –ës si dhe nenit 42 par.3 , 4 dhe 5 të LMD –ës është krijuar raporti juridik, nga i cili rrjedhin obligimet e të paditurave që në mënyrë solidare paditëses t’ia paguajnë shumën e përgjithshme prej 26.288 €, andaj nga këto fakte të cekura më lartë, pretendimin e të paditurës së dytë dhe tretë, se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, u vlerësua si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtojë edhe pretendimet tjera të cekura në revizion, por të njëjtat nuk patën ndikim që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe, ngase pretendimi se; kërkesëpadia e paditëses është aprovuar në kundërshtim me nenin 6 par 3 të marrëveshjes; se të paditurat nuk kishin kërkuar nga paditësja vazhdimin e shërbimeve, kanë qenë objekt shqyrtimi edhe para gjykatave të instancës më të ulët, për të cilat ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme të cilat arsye i mbështet edhe kjo Gjykatë, ndërsa të njëjtat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilën në kuptim të nenit 214 par. 2 të LPK –ës, revizioni nuk mund të paraqitet.

Gjykata Supreme e Kosovës e shqyrtojë pretendimin e cekur në revizion se paditësja nuk e ka vërtetuar faktin se ka kryer shërbimet e transportit dhe nuk ka propozuar caktimin e ekspertizës sipas rekomandimit të Gjykatës së Apelit, për të vërtetuar lartësinë e shumës së kërkuar për kompensim, por vlerësoi se e paditura e dytë dhe e paditura e tret, në seancën kryesore datë 9.3.2016 kanë deklaruar se ”... nuk e shohin të nevojshme caktimin e ekspertizës ...”, ndërsa sipas nenit 322 par.3 të LPK –ës, pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte për palën tjetër e bartë barrën që të provojë ekzistimin e faktit i cili e ka penguar krijimin apo realizimin e asaj të drejte.

Nga sa u tha më lart, e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 2.7.2019, E.Rev.nr.12/2019

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku

